



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. të datës 03.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV Lote" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. e datës 03.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV Lote" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 01.11.2023 i autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 03.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV Lote" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - *“Kema-Company shpk ka paraqitur një Plan Dinamik pa marrë parasysh fare formën e kërkuar nga A.K., ku kërkohet të detajohet secili pozicion. Kema Company shpk ka paraqitur vetëm kapitujt e punëve dhe jo secilin pozicion, pastaj nuk ka paraqitur datat e fillimit të punimeve apo numrin e punëtorëve siç kërkohet në FTD”.*

Ky pretendim ankimor si i tillë i referohet kërkesës mbi kapacitetin teknik dhe profesional të përcaktuar në dosjen e tenderit si në vijim: “

Kapaciteti teknik dhe profesional:

OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” për secilin pozicion të përshkruar në Paramasë. Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet data e fillimit dhe data e përfundimit të pozicionit dhe kohëzgjatja, numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Gjithashtu, së paku në rreshtin e fundit, të shënohen të dhëna për numrin e përgjithshëm të punëtorëve dhe stafit të OE të angazhuar në punishte në ditën apo datën e caktuar në “Planin Dinamik”. Në planin dinamik të shënohen ditët e pushimit (ditët e diela) si dhe ditët e festave sipas kalendarit të festave të Republikës së Kosovës

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Planit dinamik duhet të jetë I nënshkruar dhe I vulosur nga OE-ik!

Plani dinamik të cilin e ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar përmban kohëzgjatjen e punimeve mirëpo nuk evidenton edhe datën e fillimit dhe përfundimit sikurse kërkohet me dosjen e tenderit. Po ashtu në shumicën e rasteve plani dinamik i referohet kapitujve të punëve mirëpo nuk ka evidentuar secilin nga pozicionet e këtyre kapitujve të përcaktuar me paramasë sipas dosjes së tenderit. Për më tepër së paku në rreshtin e fundit nuk është evidentuar numri i përgjithshëm i punëtorëve sikurse është kërkuar përmes dosjes së tenderit. Prandaj pretendimi është i **bazuar** në tërësi.

Pretendimi i dytë (II) - *“Kema-Company shpk ka paraqitur për shumicën e stafit profesional (ing.Arben Mazreku, Ing. Eqerm Mazreku, Ing. Ditor Rexhepi, z.Liridon Ternava dhe z.Shkelzim Guta) vetëm Draft Kontrata dhe jo Kontratat e Punës ose Marrëveshjen mbi angazhimin për këtë projekt. Juridikisht nuk është i njëjti dokument si Draft Kontrata edhe Kontrata. Prandaj nuk e ka plotësuar as këtë kërkesë të tenderit”.*

Lidhur me këtë pretendim është administruar dosja me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar me ç’rast është konfirmuar se në rastin konkret janë dorëzuar draft-kontrata dhe jo kontrata. Fillimisht duhet sqaruar se draft-kontrata nuk është titull ekzekutiv respektivisht nuk përfaqëson asnjë punë juridike sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Draft i një dokumenti të caktuar (në këtë rast të kontratës) paraqet një version të caktuar që mund të manifestohet dokumenti përkatës në të ardhmen. Mirëpo në asnjë rast nuk e përfaqëson dokumentin (përfundimtar) si të tillë. Më e pakta që komisioni vlerësues ka mundur të bëjë në këtë rast është që të kërkojë sqarime shtesë lidhur me këto dokumente nga tenderuesi i rekomanduar. Definitivisht draft kontrata nuk është e njëjtë sikurse kontrata dhe nuk është e njëjtë as sikurse parakontrata. Kjo për arsye se titulli i punës juridike e determinon natyrën e titullit ekzekutiv dhe si i tillë shpërfaqë edhe pasojat përkatëse juridike. Përndryshe nuk është kontestues fakti që sipas dosjes së tenderit janë kërkuar që të dorëzohen kontratat e punës dhe jo draft kontrata apo parakontrata apo dokumente tjera të ngjashme (por vetëm kontrata). Prandaj ky pretendim ankimor është i **bazuar** në tërësi.

Pretendimi i tretë (III) - *“Kema-Company shpk për kërkesën sipas aneksit 8 të DT – Lot 3 pika 1 – tre (3) kamion, ka prezentuar në ditën e dorëzimit të tenderit vetëm Libreza të Kamionave me afat të skaduar (skadimi i regjistrimit të kamionëve është në vitet 2019, 2020 dhe 2021). Pra nuk ka plotësuar kriterin për Paisjet që regjistrohen. Madje edhe me kërkesën e A.K. të datës 20.10.2023, ku operatorit Kema-Company i kërkohej përmes Letres Standarde Për Sqarimin e Tenderit, Ku Autoriteti Kontraktues kërkon dergimin e Librezeve të Kamioneve me regjistrim valid ditën e dorëzimit të tenderit (pra data 18.04.2023). Kurse Operatori në fjalë ju ka derguar disa libreza ndër të kamionet me numer të regjistrimit: 05-504-DE, 05-503-DE, 05-175-EL dhe Autocisterne me nr. 05-492-AK Për Kamionin me numer të regjistrimit 05-175-EL dhe 05-492-AK, nuk ka dëshmi se i njëjtit ditën e dorëzimit të tenderit me datë 18.04.2023 kanë pasë regjistrim. Për të njëjtin Kamion me dorëzim të tenderit operatori ka dorëzuar kopjen e librezës me regjistrim deri me datën 25.04.2021, kurse pas kërkesës për sqarim nga A.K. me validitet deri me 25.04.2024 (dmth i regjistruar me 25.04.2023). Gjithashtu edhe për Autocisternen me nr. regjistrimit 05-492-AK, ditën e dorëzimit të tenderit nuk ka dëshmi që ka pasë regjistrim Valid. Pra dëshmitë e regjistrimit të kamionave nuk janë të plota”.*

Sa i përket këtij pretendimi, tenderuesi i rekomanduar përmes përgjigjes në letrën standarde për sqarime shtesë ka dorëzuar dëshmitë për katër (4) kamionë por që komisioni vlerësues ka gjetur se vetëm tre (3) prej tyre kanë regjistrimin e vlefshëm të cilët evidentohen me targa si në vijim:

- 05-503-DE me afat regjistrimi deri me 29.03.2024 (valide prej marsit 2023);
- 05-504-DE me datë të regjistrimit 05.04.2023;
- 05-492-AK me datë të regjistrimit 06.04.2023.

Prandaj ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi i katërt (IV) - *“Kema-Company shpk ka dorëzuar një deklaratë nën betim mirëpo i njëjti dokument nuk ka fare emërtim se për cilin projekt bëhet fjalë apo numrin e prokurimit të tij. Si i tillë konsiderojmë se është dokument jo i plotë, sepse nuk dihet se për cilin projekt është dorëzuar kjo deklaratë nën betim”.*

Lidhur me këtë pretendim është gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka plotësuar deklaratën nën betim në formën sikurse është përcaktuar përmes aneksit 2 të dosjes së tenderit. Sipas kësaj forme nuk është kërkuar evidentimi i titullit apo numrit të aktivitetit të prokurimit. Prandaj pretendimi është i pabazuar.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij me nr. 1 dhe 2 por jo edhe pretendimet me nr. 3 dhe 4. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.11.2023


Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.